



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-083
Prishtinë, më 12 nëntor 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 12 NËTOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq dhe Mufera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5 nëntor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 nëntor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 nëntor 2012.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy mbledhje plenare.

Mbledhja plenare më 15 nëntor 2012 do t'i zhvillojë punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2013.

Mbledhja plenare më 16 nëntor 2012 do t'i zhvillojë punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklaramë jashtë rendit të ditës,
2. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e cekur më lart, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të datës 16 nëntor 2012, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në seancën e radhës, më 16 nëntor 2012, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.
2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP i SLS-së 1 anëtar dhe GP 6+ 1 anëtar.

2. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për ndihmë financiare për blerjen e aparaturës së Mamografit Mobil

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e Grupit të Grave Deputete për ndihmë financiare për blerjen e aparaturës së Mamografit Mobil, e shtyu atë për mbledhjen e radhës.

3. Njoftimi i komisioneve parlamentare lidhur me pjesëmarrjen në konferencën e mbajtur në Mal të Zi

Kryesia u njoftua për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe të Komisionit për Integritet Evropian në Konferencën, e mbajtur në Mal të Zi, më 26-28 tetor 2012.

4. Njoftimi i Komisionit për Arsim lidhur me vizitën e realizuar në Bullgari

Kryesia u njoftua për vizitën e anëtarëve të Komisionit për Arsim në Bullgari, më 21-24 tetor 2012.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë

Kryesia e radhiti për mbledhjen tjetër plenare të radhës, më 16 nëntor 2012, kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, për ta informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës për takimin e tij të dytë, të zhvilluar me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel.

2. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit nga Egjipti që do ta vizitojë Republikën e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i shpenzimeve për një darkë dhe për një drekë, që do t'i shtrojnë kryetari dhe një nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, shpenzimet e përkthimit arabisht-shqip, transportin lokal, si dhe shpenzimet tjera me rastin e vizitës së delegacionit (13-anëtarësh) nga Egjipti, që do ta vizitojë Republikën e Kosovës, më 14-16 nëntor 2012.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, **Sabri Hamiti**, e shtroi çështjen e rendit të punës së organeve të Kuvendit brenda javës, që fillon të hënën, me Kryesinë e Kuvendit, tri ditët e tjera janë për komisionet parlamentare, e pastaj është seanca plenare, të enjten dhe të premten.

Kryetarët e komisioneve parlamentare ankohen se ndeshen me oraret kur i mbajnë mbledhjet në hapësirat e caktuara. Ndoshta është mirë që shefat e grupeve parlamentare ose kryetarët e komisioneve parlamentare të bisedojnë për ta bashkërenduar orarin, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjeve të komisioneve parlamentare.

Lidhur me këtë çështje diskutuan: kryetari Jakup Krasniqi, Ismet Beqiri dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*